ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për aktivitetin e prokurimit:

Nr. i Prokurimit	**214-22-5200-2-1-1**
Nr i brendshëm	**214/22/078/211**

Sa i përket tenderit për: **"Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në Objektet Policore- vazhdim afati 6".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

FLOMED SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

2/7 63, Velanis

(Adresa)

Prishtinë — *(Vendi)*

10 000 — *(Kodi postar)*

+383 44 234575 — *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

Granit Bruqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ptcflomed@yahoo.co.uk

(Adresa elektronike)

29.02.2024
(Data e parashtrimit të ankesës)

DEZINFEKTIM, DEZINSEKTIM, DERATIZIM Flomed SH.P.K. PRISHTINË

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 31.05.2022 Data e hapjes së tenderit: 15.02.2023 Njoftim mbi vendimin e AK-së: 13.02.2024 Kërkesa për rishqyrtim dt. 16.02.2023 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt.23.02.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 28 i LPP-së** **Neni 57 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar me dt.13.02.2024 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku AK-ja ka rekomanduar për kontratë grupin e OE S.V Veterina&N.N.Wenda, ndërsa neve na ka shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

1.OE fitues nuk e ka zgjatur validitetin e ofertës dhe të Garancionit , i cili është në kundërshtim më LPP dhe njoftimin e AK që Kompanitë të cilat nuk e zgjasin validitetin prandaj konsiderohën si të pa përgjegjshme dhe drejtëpëdrejt Eleminohen nga aktiviteti i prokurimit të metejshëm.

2.Sigurimi i garancionit bankar për këtë tender janë datat : 15 shkurt 2023 deri më 15 qershor 2023 me numër polises së garancionit i cili i OE S.V VETERINA & NNP WENDA Vushti 060070040088417.
3. Validiteti tenderit të OE OE S.V VETERINA & NNP WENDA Vushti, ka qenë I pa siguruar me garancion nga data 16.qershor 2023 deri më daten 14. Nëntor 2023.

4. OE fitues OE S.V VETERINA & NNP WENDA Vushtri, nuk e ka bërë vazhdimin e sigurimin e tenderit gjatë periudhes kur na është kërkuar të gjithë OE pjesëmarrës, qështë kërkuar nga OE nga AK.

5.Validiteti është dashtë vazhduar më Garancion valid prej dates: 16 qershor 2023 deri më 14 nëntor 2023, mirëpo OE i rekomanduar për kontratë nuk ka vazhduar validitetin e tenderit dhe sigurimin e tenderit, prandaj për këtë periudhë oferta e këtij OE ka mbet pa validitet dhe pa sigurim, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm sepse nuk ka vazhduar validitetin e tenderit dhe sigurimin e tenderit, pavarësisht kërkresës së AK-së.

Ne kemi kërkuar sqarime nga autoriteti kontraktues në lidhje me vlëfshmërinë e tenderit dhe të sigurimit të tenderit, ndërsa në përgjigjen që na ka dhënë autoriteti kontraktues nuk na ka ofruar dëshmi se është bërë vazhdimi i validitetit dhe sigurimit të tenderit për këtë periudhë kohore, pra nga data16 qershor 2023 deri më daten 14 Nëntor 2023.
Dihet që ofertat e oepartorëve ekonomik nuk lejohet të mbeten pa vlefshëmri dhe pa sigurim asnëj ditë.

6.Më datën 14 nëntor 2023 është kërkuar të bëhë prapë Sigurimi i Garancionit deri më datën 13 mars 2024.
Përderisa nuk ka vazhduar sigurimin e tenderit dhe validitetin e tenderit ky grup i OE nuk ka shpreh inetersim për këtë aktivitet të prokuirmit, pandaj është palë pa interes juridik material, sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së.

Dihet fare mire nëse njëri prej OE, që nuk e bënë Vazhdimin e sigurimit të Garancionit, atërë ai konsiderohet Operator i Eleminuar në pjesëmarrjen në Tenderin Publikë të PK-së.

Edhe rregullorja Nr.001/2022 Për Prokurim Publik e përcakton qartë se kur nuk vazhdohet validiteti i ofertës operatori ekonomik konsiderohet i papërgjegjshëm.

Neni 30.6 Është e hapur për secilin OE të vendos nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre.

7. Stafi "Profesional" i kompanisë fituese OE S.V VETERINA & NNP WENDA Vushtri ka prezentuar dokumentacion jo validë dhe jo të plotë.

Stafit Teknik dhe menagjerial i punëtorëve nuk kanë Licenca të çërtifikuara më validitet prej Odës së Mjekëve që duhët të bëhët në Ministrisë së Shëndetësisë dhe që të jenë të noterizuara në Ministrinë e Arsimit të Republikën e Kosovës konform ligjeve në fuqi.

8. Të gjithë Teknikë sanitarë nuk e kanë Certifikat e licencuara në Odën e teknikëve sanitarë pranë Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës."

9.Theksojmë që Teknikët sanitarë kanë kryer disa orë praktike (kurse disa orëshe të të marra më valutën Lek në Tiranë,Republikën e Shqipërisë ku të njajat çërtifikata nuk janë të noterizuara asë të licencuara për punëtorët :

a)**Zenun Haxhnikaj**,teknik i veterinës që e ka diplomën e SHMT dhe nr.protokolli 252-00280201 ,dt.e lëshimit 19.maj 2001, i cili nuk e ka Licencen nga Oda e teknikëve sanitarë pranë Ministrisë së shëndetësisë, konform Ligjit Nr.2003/2"për pesticide" të datës 16 tetor 2003, Udhëzimit administrativë Nr.01/2004"për caktimin e kushteve për licencimin e mjekëve specialist-Epidemiolog"si dhe Udhëzimin administrativë Nr.15/2004"për percaktimin e kushteve të veçanta për "Prodhim,importim,eksportim, plasim ne treg dhe aplikim profesional të pesticideve'' të datës 18 nëntor 2004 nga M.B.P.ZH.R. t ë Kosovës ,në Seksionit e mbrojtjes së bimëve- njësia e pesticideve dhe e plehrave artificiale që duhët të lejohet më Licencë për Aplikues- përdorues të pesticideve -DDD. Ata të gjithë duhen të Licencohen më çërtifikatë valide si Epidemiologu, në Odën e mjekëve pranë Ministrisë e Shëndetësisisë si dhe diploma e tij si shtetas i Republikës së Serbisë nga Tutini (Epidemiologu) i firmës fituese nga Kosova në këtë tender , është banorë resident i Tutinit.I njëjti duhet t'a ketë çërtifikatën e sigurisë (përshtatshmerisë) nga Agjencioni i AKI-së për të mbikqyrë mbarvajtjen e punëve të DDD-së në objektete e brendshme dhe te jashtme policore në tërë teritorin e Policisë së Kosovës.

10. Sipas hulumtimeve tona epidemiologu boshnjak nga Tutini i Republikës Serbe nuk e posedon çërtifkatën e tillë.

11.Edhe diploma e epidemiologut nuk është e nostrifikuar sipas Ligjit në fuqi mbi" Nostrifikimin e Diplomave per të huajtë " të cilët punojnë si mjek specialist (Epidemiolog) e që duhë të Nostrifikohet sipas ligjit në fuqi në Ministrinë e Arsimit të Shtetit të Kosovës.

12.Epidemiologu i punësuar nuk ka" Licencë"-Leje pune (Cërtifikatë pune) për përiudhë e caktuar sa zgjatë Tenderi që lëshohet nga Oda e Mjekëve për epidemiolog në Ministrinë e shëndetësë, si shtetas i huaj...

13.Pra siq shifet Epidemiologu Dr.Mithat Elmaz Eminovici , nuk e ka letërnjoftim -si shtetas i Kosovës por ka letërnjoftim serb (të Tutinit)pa leje qëndrim në Kosovë, por i njëjti është emigrantë boshnjak në Kosovë)i cili nuk është i evidentuar në Zyrat e MPB për të huajt konform Ligjeve në fuqi të RK-së.

14.Çka është edhe më keq, AK i Policisë së Kosovës (ex officio) ka qenë dashtë të hulumtojë edhe disa gjëra nga vetë Komisioni i AK (Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse) për " Diplomën" jo valide të specialistit të epidemiologjisë, ngase sipas neve ekziston dyshimi në sa vijon: Diploma e epidemiologut Dr.Mithat Elmaz Eminoviçit e cila është e lëshuar nga Fakulteti i Mjekësisë - Univerziteti i Beogradit nuk është e noterizuar tek noteri qoftë në Serbi apo në Kosovë dhe e njëjta nuk e ka vulën e rrumbullakët e ase ate Apostile i cili dokument duhët të jetë i vulosur dhe i noterizuar në Ministrinë e Arsimit në Republikën

e Kosovës (dhe se i njejti po punon pa dokumenta validë në firmën" S.V VETERINA & NNP WENDA" Vushtri .

15. Sipas informatave të marra nga interneti, Dekan i Fakultetit të Mjekësisë nga data : 14.06.2021.është Prof. Dr.sci.Lazar Davidovic, për vitet shkollore: 2021/2022,2022/2023 dhe 2023/2024.Për verifikim e këtyre të dhenave do të ishte e udhës ta bënte autoriteti kontraktues. Këtë gjë mund ta gjeni dhe verifikoni në sajtin zyrtar serb të Universitetit të Beogradit .Klikoni këtu :

http://med.bg.ac.rs/?p=22376&script=lat,

Ndërsa dekani i nënshkruar do ta gjeni në Diplomën sips nesh të falsifikuar në çirilicë " të Dr Mithat Elmaz Eminovici.

16.Nuk ka kurrfarë evidence që dr.Mithat Elmaz Eminoviçi, ku Diploma e tij e lëshuar me dorë nga Univerziteti i Fakultetit të Mjekësisë në Beograd është e noterizuar nga Noteret serb të Serbisë e as të Kosovës e as e nostrifikuar konform Ligjit mbi pranimin dhe Njohjen e kualifikimeve të shkollave të mesme, të larta profesionale dhe Uiversitare të fituar jashtë Republikës së Kosovës", që kërkohën të jenë të pranueshme jashtë Republikës së Serbisë:

Gjeni këtu :

https://masht.rks-gov.net/naric-kosova-qendra%20p%C3%AB-njohje%20-te-diplomave/

17.Pra, dr.Mithat Elmaz Eminoviç nuk ka licencë nga Oda e Mjekëve e Republikës së Kosovës, dhe i njejti punon kundërligjshëm (pa Licencë) në teritorin e Kosovës , çka është e kundërligjshme dhe e dënueshme më Ligj të punojë një shtetas i huaj si mjek pa Licencë në Kosovë (pa lejeqendrim).I njejti nuk është banorë rezidentë i Kosovës .

18. Diploma e tij është në Cirilicë dhe është Diplomë e dyshimtë, për çka Policia e Kosovës (ex officio) duhej ta verifikojë diplomen e tij nëpërmes kanaleve diplomatike të Republikës së Kosovës në Zyrën ndërlidhëse në Beograd ose nëpërmes Eulex-it.

19.Siç e cekëm më lartë, Doktori nga Tutini, po jetojka në Vushtri (pa Leje qendrimi si emigrant në Komunën e Vushtrisë . I njëjti nuk e ka ofruar "çertifikatën e sigurisë nga Agjencia e Intelegjencës Kosovare (AKI), apo gjykata e Mitrovicës, apo SPB e Vushtrisë , për çka ka qenë dashtë AK "ex officio" ti mbledhë të dhenat relevannte , të dihet kush është ky njeri që përfshihet në objektet policore.

20.Stafi "profesional "i kompanisë fituese ka prezentuar dokumentacion jo valid dhe jo të plotë të stafit Teknik dhe menagjerial ngase punëtorët janë të Palicencuar dhe të çertifikuar nga Oda e teknikëve sanitar - Ministrisë së Shëndetësisë.Ata i kanë kryer ca kurse në Tiranë që sipas Ligjit nuk mund të Licencohen duke filluar nga :
21.**Zenun Haxhnikaj,** Teknik i veterinës më diploma të SHMT, është i certifikuar më nr.protokolli 25200280201 datë 19 maj2001 në Tiranë ka të kryer një kurs në Tiranë.Është i pa licencuar nga MSHK.

22.**Safet Osmani,** është i certifikuar më një kurs në Tiranë prej dt.22.8.2020-25.08.2020 nuk është i Licencura nga Oda e teknikëve sanitar pranë MSHK-së.

23.**Valbona Sadiku** (femër) ka të kryer një kurs 3 ditor në Tiranë prej dt.22.8.2020 deri më 25.8.2020 i mungon Licenca e teknikut sanitar të Odës së teknikëve sanitar të MSHK-së.

24.**Bislim Maloku**,është i certifikuar me një kurs 5 ditor në Tiranë, por i njajti nuk është i Licencuar nga MSHK.

25. **Valon Azemi, Arben Vllahia** kanë të kryer si të sipëshenuarit një kurs në Tiranë, por certifikatat e tyre nuk mund të Licencohën në bazë të Ligjit në Odën e teknikëve sanitarë të MSHK-së, ngase nuk i plotësojnë kushtet administruese për Licencim.

26.Kompania fituese në fjalë, ka ofruar një Raport nga Drejtoria për Menagjimin e Objekteve (DMO) Policore si dhe inspektimin final" në Policinë e Kosovës, mbi punët e kryera të izolimit te Terasës në DRP - SP në Lipjan, që s'ka të bëjë fare, mbi ndonjë shërbim të kryer të D.D.D.së, e asë Repelim të gjarpinjve (Zvarranikëve) në Policinë e Kosovës, por ka të bëjë më vënje llamarine (konstruktive) teknike të një objekti policor, që dhashtë Zoti të qëndrojë e mos të ndodhë ndonjë avari siç i ndodhi para ca ditësh Komunës së re në Kalabri të Prishtinës, që i fluturojë kulmi dhe e plagosi një qytetrë të rastit në rrugë ku jeta e kësaj qytetarje u rrezikua. Prandaj ku mbetët përgjegjësia individuale e kompanisë fituese të Tenderit.

27.Preparatet e kompanisë fituese nuk kanë asnjë data sheet dhe nuk janë sipas Specifikimeve teknike të dosjes së tenderit që i ka kërkuar njësia kërkuese e Drejtorisë Shëndetësore gjegjësisht e Departamentit epidemiologjikë e Policisë së Kosovës duke filluar nga Insekticidet që s'janë adekuat.

Metodologjia e punës për DDD që është kërkuar nuk është adekuate dhe profesionale ata asnjë fjalë nuk e kanë treguar se si bëhët repelimi i gjarpijve, dhe sa i përket repelimit të gjarpijve. E kanë futur Lejen e një produkti Biocid preparat rodonticid i ndaluar për gjarpijë, sepse ky ka përbërës "naftalinë" dhe të" sulfur-it " të ndaluar nga EPA USA, që s'ka data sheet.

28.Për fushat e përgjithshme administrative e regjistron produktin gjëja biocid për import, ku Kompanisë" Veterina" i lejohet importimi i preparatit repellent më substance aktive "Cinnamomum Camphora bark oil"me emrin fabrikor "Disabitutate retilit " (paketim 12lit x1). Gjithsejt 24 copë Bile gabimisht(që sipas nesh më qëllim,për të mos ju rënë auditorëve në mend që **është repellent i ndaluar** e shkruajn **preparate Insekticid**).

29.Pra preparati " Repelent", i ofruar nuk mund të përdorët për largimin e gjarpijve sepse është insekticid, por është një Repelent "Cinnamomum Camphora bark oil", i rrezikshëm që ndikon në biodiverzitet të ambientit ngase **është kancerogjen** .

30.Të njajtat vendime indikative e ka më preparatin e ndaluar për gjarpijë që ka dhënë MH ,Departamenti i importit për Produkte biocide që e pat ofertuar edhe firma e Doktor Extreminator SHPK Prishtinë.

Shif vendimin nëse klikoni:

Vendim nr. 2023-0283.pdf

Ekspertize nr. 2023-0283.pdf

Në këët rast edhe OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar preparatin e ndaluar, prandaj edhe OSHP-ja duhet të trajtojë njëjtë këtë ofertë sikurse ofertën e Doktor Extreminator SHPK Prishtinë.

Lloji i këtij produkti gjëja Biocid (PT) Insekticid duhet të cekët që është sol për repellent zvarranikë. por duhet qitur pluhur syve njësisë kërkuese (lexo komisionit të AK) në lëminë e DDD-së më preparat kancerogjen .

31.Preparatin repellent (për Minstrinë Hapësinore është i Lejuar për përdorim) ndërsa per agjencinë EPA - të USA-së dhe Evropës këtë preparat e ka në Listë të Zezë sepse ka Naftalinë dhe Sulfur.

Mu për këtë preparat është fsheh (lexo larguar faqja e 2 e Licencës për produkte biocide e MH " Leja për produkteve biocide" (nr.të protokollit 5294—2/23 të dates 14.09.2023 të MMPH) që e ka Kompania S.V.Veterina"-Vushtri , i jipet leja për disa produkte insecticid,e që fatkeqësisht ato produkte nuk përkojnë me specifikimin Teknik të Njësisë kërkuese (siç e ka kërkuar Shefja e Epidemiologjisë në Drejtorinë shëndetësore të PK_së dr.Merita Zogu) e cila po ta kishte këtë dokument do të dinte që nuk përputhen preparatet me Specikime të kërkuara nga Njësia kërkuese.
Në këtë listë që ka gjithsejt 6 preparate që kanë Leje për përdorim nuk janë adekuat për Shërbime DDD në Policinë e Kosovës por këto preparate përdorën si produkte për largimin e insekteve nga pemët, rrushi (në plantacione të agrokulturës, për çka kjo firmë edhe mirrët për spërkatje agrokulturore) .
32. Asnjë preparate nuk ka fletëpalosje, data sheete nga prodhuesi, katalogje në gjuhën shqipe apo angleze për mënyrën se si duhet përdorur të njëjtit produkte . (ngase njeri syresh ka sulfur dhe naftalinë), që janë elemente të rrezikshme për biodiverzitetin natyror (për njerëz dhe shtazë, qejë të Policisë në K-9).

33.**Ky preparat i ofertuar nga kompania fituese është i rrezikshëm për prishjen e organeve të nuhatjës së qejve policer _K9.**

Qejve ju prishët ndjesia e erërave .Nuk i shijojnë erërat dhe janë jo efikas më nuhatje për zbulimin e drogës apo ndonjë materje tjetër të qejve antiterroristë apo qejve gjurmues (ne vrasje).Preparati sipas literaturës shkencore është tepër kancerogjen për organet e frymarrjës (Carcinoma e mushkërijve) si dhe për kancerin e gjakut tek njerëzit dhe shtazët.

Më shumë lexoni data sheetin :

https://www.essentialoilsdirect.co.uk/aromatherapy/msds/camphor_oil_essential_oil.pdf
Essential Oils Direct Materjal Safety Data Sheet:camphor oil White (page 3-9).

https://www.amazon.com/GuruNanda-Essential-Vitamins-Mouthwash-Supports/dp/B0BVFXGMLW/ref=pd_rhf_dp_s_pd_crcbs_d_sccl_1_4/137-6588052-8329540?pd_rd_w=HPbYz&content-id=amzn1.sym.31346ea4-6dbc-4ac4-b4f3-cbf5f8cab4b9&pf_rd_p=31346ea4-6dbc-4ac4-b4f3-cbf5f8cab4b9&pf_rd_r=ZNRKW256RW5TT635GXQD&pd_rd_wg=TLWb8&pd_rd_r=29a6ee0f-d123-4169-80cf-aa76de3a43bf&pd_rd_i=B0BVFXGMLW&psc=1

si dhe : **Vendim e OSHP-së nr. 2023-0283.pdf**

Ekspertize nr. 2023-0283.pdf, që të mos I përseritim gjërat e shtjelluara nga OSHP.

Revizioni për preparatin për "largimin" e gjarpinjeve është bërë për here të fundit me dt.07.09.2016 ne SDS.(Faqe8 9-9)00.

Ndërsa indikacionet negative janë zbuluar nga Agjencioni "EPA" USA , kur janë larguar ushtarakët amerikan nga "Lufta e gjirit " në vitin 2022.

https://www.essentialoilsdirect.co.uk/aromatherapy/msds/camphor_oil_essential_oil.pdf

Fatkeqësiht ky preparat distribuohet në Republikën e Serbisë nga një firmë Serbe (Beogradi) ndërsa kompania fituese e sjellë në Kosovë pa kurrfarë Leje importuese në teritorin e Kosovës. Preparati është i rrezikshëm sepse ndikon në biodiverzitet natyral.....

34.Asnjeri prej këtyre produkteve (që e ka lëshuar Licencën MH (referenca: 23_5294-1-496-DMMU) , nuk janë të kerkuara dhe nuk janë adekuate (ekuivalente) më tender të PK-së DDD dhe Repelim të zvarranikëve(Gjarpijve) në Policinë e Kosovës.(Mungon Metodologjia e punës për zvararanikë dhe Dezinfektues.

35.Prepartet që kompania i ka ofruar për dezinfektim nuk kanë Leje të MHO-së dhe nuk janë më data sheet, asë fletëpalosje e asesi ekuivalente më çka është kërkuar nga Njësia kërkuese me Specikime tenderuse.

Theksojmë që Kompania "Flomed" Sh.P.K Prishtinë ka ofertuar më preparate cilësore ashtu siç janë kërkuar nga njësia kërkuese më Specifikim teknike të lejuara nga OBSH dhe Kryeinspektorati Sanitar i Qeverisë së Kosovës.

36.Kompania fituese e tenderit, më asnjë preparat Dezinfektues nuk e ka marrë Licencën në Ministrinë e planifikimit hapsinore apo në Autoritetin kontraktues të AKPM-së për produkte medicinale (preparate dezinfektuese).OE fitues ka një Licencë të marr nga Ministria hapësinore por jo me Specifikime të kërkuara nga Policia e Kosovë-Departamenti epidemiologjik shëndetësor .
37.Kompania fituese pa leje të MH e asë të AKPM-së ka futur disa fotografi të disa dezinfektuesve jo adekuat për objekte policore, që nuk janë adekuat dhe ekuivalent sipas Dosjes së Specifikimeve teknike.

38.AK (Prokurimi na ka dhënë disa fotografi të këtyre Dezinsektuesve pa shënime përcjellëse (data sheete,fletëpalosje të preparateve) si fjala vjen:

38..Cryzantemum cinerarriqe folium cast 0,01 , që ka në vete përbërës kimik permethrin 0,25 të cilit dokument i mungon data sheeti dhe fletepalosja për mënyrën e përdorimit të preparatit si dhe katologu i prodhuesit.

39.. Në dosje të tenderit kompania fituese ka futur preparatin francezë që sështë kerkuar e as ekuivalent më emrin " **Aqua K-Othrine**", i cili nuk është **në Lejën e importit nga MH** e asë katalog e as data sheet më fletëpalosje për mënyrën e përdorimit.

Ne dijmë se si përdorët ky preparat ngase kemi punuar më të njëjtin preparat,por kjo firmë ka lexuar në internet që ekziston një preparat i tillë që përdorët si Insekticid.

Sa për informim të OSHP-së : Distribues në Ballkan i preparatit insekticid "Aqua K-Othrine" është firma "Primatex" Shkup, Republika e Maqedonisë Veriore ndërsa prodhues

është fabrika "Agrevo" nga Lioni i Francës dhe nga një firmë e Malezisë https://www.mkhardware.com.my/showproducts/productid/3685817/cid/383129/aqua-kothrine/

Kompania e jonë ka verifikuar tek distribuesi "Primatex" (Shkup) a ka distribuar ndonje sasi të këtij preparati insekticid S.V"Veterina' Vushtri"Aqua _Kothrine" ,Departamenti i shitjes në Shkup me telefon na Njofton më një "JO", asë që kanë dëgjuar për këtë firm kosovare.Ata thane se e njofin firmën Flomed Prishtinë, Doktor extreminatorin Prishtinë, Ekologjinë Ferizaj, e asnjë firmë tjetër

40.Firma fituese e tenderit konkuron edhe më një ish preparat insekticid Italian "Deadyna" i cili preparat është larguar nga tregu botëror (2021) .

41.Insekticidit "Metocid" nuk është në Listën e Certifikimit të Ministrinë e ambinetit dhe planifikimit hapësinor, që i mungon data sheeti si dhe katalogu dhë mënyra e përdorimit, ky e ka futur edhe këtë preparat .Profesionalizëm jo mahi.

42.Edhe preparty "Sojet" për miza nuk gjendët në listen për Produkte biocide të cilit i mungon data sheeti, katalogu për mënyrën e përdorimit.Pra edhe ky preparat i ofertuar nuk gjëndet në listen e Ministrinë e ambinetit dhe planifikimit hapësinor si product biocid insekticid.

43.Insekticidi :Neopitroid alfa" i mungon data sheeti, katalogu si dhe mënyra e perdorimit

44.Insekticidi "Neopitroid pluhur" i mungon data sheeti, fletëpalosja, katalogu.

45.Insekticidi "Neopirox plus" i mungon data sheeti dhe fletepalosja bashkë më katalog.

46.Preparti Insekticid Cypermethrin (in polvere durafast 250 gram) nuk e ka përqindjen e koncentrimit si preparati më Specifik Teknik të AK "FOVAL CE" të prodhuesit italian Kollant & Adama. Preparati Cypermethrin i ofertuar nga fituesi nuk ka edhe data sheet(listen e sigurimit) e asë katalog.Preparatit dezinsektues (Insekticid) që ka ofertuar kompania fituese nuk gjendet në Specifikim Teknik të Tenderit të Policisë së Kosovës.

47. AK I PK_së -njësia kërkuese e ka kërkuar preparatin që i ka të gjitha substancat kimike aktive sa vijon :

:Cypermethrin, Permethrin, Piperonyl Butoxide. 92 g / litre, 23 g / litre, 115 g / litre(që është kërkuar nga Shërbimet shëndetsore epidemiologjike të PK-së) .

Kompania Flomed ka ofertuar më këtë preparate që ka Licencë nga Ministrinë e ambinetit dhe planifikimit hapësinor. Dhe emri i këtij preparati është "Foval CE" , i prodhuesit Kollant &Adama Italy, që Flomed" SHPK ia ka bashkangjitur data sheetin autorizimin distribotues etj.Ky preparat dezinsektues është treguar mjaft efikas në largimin e insekteve.gjatë punës tone 10 vjecare në Polici dhe në Spitale të Kosovës si dhe në disa Ambasada etj..

Shifni preparatin e kërkuar nga njësia kërkuese:https://www.nexles.com/eu/kollant-insecticide-foval-ce-1-litre.html

Ndërsa kompania fituese oferton më një preparat jo të kërkuar nga Njësia kërkuese(epidemiologjike) e AK sa vijon :

48.Insekticidin " Delthametrin" që është preparat shumë i zbutur fabrikor më 2,5% më përberje kimike piretroid , më emrin gjenerik fabrikor fabrikor "Delta EC", kanistra 5 L i prodhuesit Ascenza

Ky preparat përdoret për eliminimin e insekteve në plantazhe Agrokulturore . Bënë pjesë në insecticide fitosanitarë(FDS) .Më këtë insekticid 0,4-0,5 lit/ mund të spërkatën 1 ha /sipërfaqe).Produkti në fjalë nuk është i kërkuar nga Njësia kërkuese, por është kërkuar "Foval CE".
Preparati Delthametrin nuk ka data sheet, katalog nga prodhuesi (Specikime kimike)dhe nuk është ekuivalent më preparatin që ka ofertuar Flomed, konform specifikimeve teknike të AK.

Shif produktin e ofruar nga fituesi I tenderit:

https://www.tienda.sercopag.com/producto/delta-ec-deltametrin-25-insecticida-piretroide/

Preparti insekticid përdorët në Bujqësi (në kopshtije , plantazha rrushi si dhe sperkatje të pemëve kundër insekteve (mollave,dardhave,rrushit)

http://en.granoro.kz/product/74-fagiolini-rigati-n-50

etj.

49.Preparati rodonticid Bromadielen (Rati grano professional 5 kg) eshte pa data sheet (nuk ka përmbajtje kimike të kërkuar komform Dosjes se tenderit bromadiolone 0,005%.

Ky është rodonticide por nuk është konform dosjes tenderuese që është kërkuar (në DFT) ngase në dosje kërkohet që Deratizues për objekte policore duhët të jetë deratizues Rodonticid-Antikoagolant i gjeneratës së dytë më përbërje të preparatit sa vijon:

Bromadiolone 0,005 dhe brodifacoum 0,005%.Këto preparate duhet të jenë në formën e dritherave gruri,peleti dhe briketi.

Këta "Rati grano professional" nuk janë ekuivalent e asë me efekt të njajtë.

50.Dokumentacioni përkatës i këtij rodonticidi që ka ofruar firma fituese nuk është i shoqeruar me data sheet, me listë të sigurisë teknike dhe certificata të analizave përkatëse, siqë e kërkon Njësia kërkuese e AK.Prandaj edhe nuk e plotëson kriterin e kerkuar .

Ndersa, kompania Flomed SH.P.K.Prishtinë e ka ofruar preparatin që është kërkuar më të gjitha specifikimet teknike të sigurisë, me autorizime të prodhuesit Kollant&Adama Itali, më data sheete, fletëpalosje të preparatit të kërkuar si dhe Cërtifikatë importi nga MH.

Kompania fituese ka konkuruar edhe më një preparat Insekticid

51.Më emrin "Sodium dimethyldithiocarbonate solution"(Scatole americane in cartone 600 a 799 mm) që nuk është kërkuarNga njësia kerkuese e autoritetit Kontraktues.
Ata kanë kërkuar: që preparati të këtë këta përbërës kimik:

Active Substances

Cypermethrin, Permethrin, Piperonyl Butoxide

Active Substance Concentration

92 g / litre, 23 g / litre, 115 g / litre

Documentation

Authorization Foval CE

Authorization Extension Foval 2024

Security Sheet Foval CE

Kompania fituese nuk ka ofertuar më preparatitn e kërkuar :

https://www.nexles.com/eu/kollant-insecticide-foval-ce-1-litre.html

I cili është preparate i sofistikuar për dezinskektim të objekteve policore, kazermave ushtarake e objekteve të ngjajshme.

Eshte mjaft e rendësishme të cekët se Zyrtarët e Prokurimit janë jo profesional të pa përgjegjshëm dhe efikas në punë.

52.Autoriteti Kontraktues, ka kërkuar Listën e Stafit professional për shërbime të DDD-së që të jetë i nenshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik.Minimum tre (3) punëtorë teknikë më eksperiencë në lëminë e DDD-së.Më Dy(2) vite përvojë pune të dëshmuar më reference.Më kontratë pune ose më Parakontrata te Punës valide me punëdhënësin për angazhim në këtë Projekt të DDD-së.

2Në këtë rast OE fitues, referencat e të cilit ua ka lëshuar punëtorëve të vet i ka të pa nënshkruara dhe të pa vulosura..

3.Në listen e Stafit nuk është emri i një punëtori F.Rrahmani por vetëm Kontrata e lidhur në mes tij dhe punëdhënësit, kurse përvoja nuk është e dëshmuar me reference. Në mes punëdhënësit dhe punëtorëve të cilët janë në listë nuk janë në rregull (nenet e tyre bien ndesh me njera tjetren).
Kontrata e V.Sadikut tek Neni 2 ceket se kjokontratë nuk mund të jetë më e gjatë se 120 ditë kalendarikë brenda 1 viti kalendarik, kurse tek neni 6 ceket se punnëmarrësi do të angazhohet nga dt.01.01.2018 deri në kohë të pacaktuar.E njejta kontatë vlenë edhe për punëmarrsin tjetër A.Osmani ku ndryshon vetë data e angazhimit 01.04.2019.

Tek kontrata tjetër A.Osmani ku ndryshon vetëm data e angazhimit 01.04.2019.
Tek kontrata tjetër B .Maloku, neni 2 thotë se kjo kontratë Nuk mund të jetë më e gjatë se 2 vite kurse tek neni 6 cekët se punëmarrësi do të angazhohet për 36 muaj për Projektin në fjalë. E njëjta kontratë është edhe e punëmarrësit A.Vllahija.
Kurse tek kontrata e punëmarrësit V.Hyseni, përveç Nenit 2 ku thotë se kjo kontatë nuk mund të jetë më e gjatë se dy vite, kurse tek neni 6 thuhet se punëmarrësi do të angazhohet

nga 20.03.3021 deri 23.03.2023. me mundësi vazhdimi deri në përfundim të projektit në fjalë(kurse projekti është publikuar më 10.06.2022).

Ndërsa për nenet e më poshtme për të cilat janë cekur nga OE, AK nuk mund të jep asnjë përgjigje sepse kjo rregullore ka hy në fuqi më 20.10.2023, pas publikimit të Njoftimit për kontatë, prandaj në këtë rast vlenë Rregullorja e vjetër.

53. OSHP-Pa të drejtë ligjore, hjekë kriterin Ligjor që OE s'ka nevojë të këtë mjek specialist epidemiolog , për shërbime te DDD

Theksojmë që sipas OBSH-së, Kryeinspektoratit sanitar të Kosovës, në krejt botën mjeku epidemiolog është parësor në fushën e DDD-së. Sipas Ligjit shëndetësor të RK, mjeku specialist Epidemiolog duhët të jetë i licencuar për punë dhe shërbime D.D.D nga Oda e Mjekëve të Republikës së Kosovës, dhe Diploma e Mjekut të shtetasve të huaj duhet të jetë e nostrifikuar sipas ligjit në Ministrin e arsimit të Republikës së Kosovës, poashtu edhe Teknikët sanitar.

Gjithashtu edhe Diplomat apo Certifikatat e lëshuar në Labirinthe të ndonjë shteti tjetër për teknikë sanitar duhët të çertifikohën në Odën e teknikëve sanitar nga Bordi i Minsitrisë shëndetësisë së Kosovës konform udhëzimit administrtaiv .

Të gjithë të diplomuarit jashtë teritorit të Kosovës, duhet ti kenë çërtifikatat e DDD-së që janë të lëshuara në disa agjenci e jo nëpër "Labirinthe" të Tiranës, e që s'janë të Licencuar në vendin e vet. Pra duhet të jenë të licencuar nga komisioni përkatës i Bordit të Odës së Teknikëve sanitar pranë Ministrisë së shëndetësisë së Kosovës (sipas Udhëzimit Administrativ 10/2003) për Regjistrimin e Licencave të profesionistëve shëndetësor në bazë të nenit 5.5,5.6 me vendimin e komisionit për Regjistrimin dhe Licencimin te mjekëve, t'ju Lëshohet Licenca e punës më date të lëshimit të Licencës dhe date të skadencës për cdo individë për Dr. epidemiolog, Teknik sanitar duke i plotësuar kërkesat administrative të parapara më Ligjin shëndetësor të Kosovës.

54.Asesi OSHP nuk ka të drejtë të Shfuqizojë vendimet e Ministrisë shëndetësore pa konsulta ligjore dhe qeveritare ngase bënë shkelje Ligjore të Ligjit mbi sëmundjet ngjitëse - infektive më Largimin e Licencimit të Mjekëve epidemiolog.

55.Ne si Kompani - Nuk e dijmë më çfarë të drejte OSHP e hjekë kriterin "epidemiolog", pa u konsulltuar me MSH, ngase Epidemiologu e zënë vendin parësor për sëmundje ngjitëse dhe shërbime D.D.D.

https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2587

Shpjegim:

56.Theksojmë, që Kompania fituese në tërësi është e papërgjgjshme, është jo profesioniste për DDD), prandaj duhet të eliminohet nga konkurrenca.

Kërkesa jonë për Rishqyrtim e dates 16.02.2024 është refuzuar si e pabazë më dt.16.02.2024 , kur dihet që jemi Kompania më e mira në Kosovë dhe rajon më përvojë në Lëmin e DDD-së , si dhe në liferimin e preparteve DDD (mbi 3 decenie në Kosovë dhe jashtë sajë në ish RSFJ.).

Mosdëgjimi i këshillave profesionale nga Zyrtarët e lartë të Prokurimit, ka zgjatur edhe mosefikasitetin e zgjidhjës së këtij Tenderi tash e 2 vjet. Sepse firmat operuese, me profesionistë mjek "Veterinar" dijnë të Repelojnë kafshët, e jo të kryejnë shërbime mjaft suptile të DDD-së në Spitale, foshnjore, shkolla, kazerma ushtrake, objeket policore, ambasada etj.

57.Theksojmë që firma në fjalë e ka cekur më 5 -6 rreshta metodologjinë e punës por ka harruar gjërat ti shtjellojë se si bëhet dezinfektim dhe repelimi i gjarpijve, sepse me prepartin që ka ofruar për gjarpijë nuk guxon të bëhet Repelimi i gjarpijve.

Bashkangjitur keni:

e) Kopja komplet e preparteve të notifikuara si produkte biocide(ku i është hjekë faqja e 2-të e dokumentit të referencës nr 23/5294/1-496/DMMU të dates 22.09.2023.

f) -Formulari për kërkesë e dt.22.02.24 me nr.prot.1080/24 për dokumentin që nuk na është dhanë nga zyrtari i Prokurimit në PK, më arsytim që është humbur në OSHP ?

g) Sipas nesh jo e vërtetë ngase këtu qendron dallaverja që preparatet e notifikuara nga MH nuk korespondojnë me Specifikime teknike të preparteve DDD.

h) Metodologjia jo e plotë me preparate të kërkuara.

i) Vendimi i refuzimit të ankesës tonë nga data 23.02.2024

Lusim Kryetaren , Sekretarin organizativ te OSHP-së të caktojë ekspert të fushës përkatëse fitosanitar (të jashtëm), kimist, teknolog, epidemiolog ,higjenist etj., dhe të mos e trajtojnë lëndën ekspert që nuk dijnë për çka përdoret preparati.

Theksojmë që duke u bazuar në sqarimet tona profesonale (sa i përkët D.D.D-së dhe repelimit të gjarpijve pretendimet tona ankimore janë të bazuara me dokementa, dhe ankesa e kompanis Flomed duhet të aprovohet si e bazuar dhe të mos krijohet konfuzitet në mes të OE të interesuar në aktivitetin e prokurimit dhe ti jipet profesionistit , që në këtë rast është firma jonë "Flomed SHPK", më përvojë dhe profesionalizëm 30 vjeqar dhe të vetmit distributor të autorizuar që jemi për preparate DDD dhe Makina spërkatëse profesionale nga IGEBA gjermani si dhe aparaturë për largimin e zvarranikëve (snakes repellent më bateri dhe dhe me mbushje solare nga USA, dhe mu për këtë çmimi është më i lartë dhe garancion disa vjeqar i larguesve të gjarpijve.

Dokumentacioni I bashkangjitur nga FLOMED SHPK PRISHTINE:

Si dhe dokumentacion tjeter i certikikatave,diplomave,Listes se preparteve gjeja biocide nga Ministria Hapsinore,jo Sipas Specifikimeve adekuate nga AK.

Faqja e 2 e Licences për "produkte" biocide të firmës fituese nuk është fare e përafërt siç janë kërkuar nga AK (Shërbimet shëndetësore të PK_së sipas specifikimeve adekuate 1% kërkuara më DFT) që s'janë as për se afermi ekuivalente por te njejtem e kemi gjete dhe marrë në Ministrinë e ambinetit dhe planifikimit Hapsinore. Arsytimi i AK-sëgjeja ka humbur faqja e 2 e dokumentit në OSHP?

Të gjithë operatorët ekonomik tjerë me çmim më të ulët janë të papërgegjishëm dhe arsyet e eliminimit të këtyre opeartorëve ekonomik nga autoriteti kontraktues janë edhe pretendime tona ankimore.
Pra OE Monuni, OE Vlera SHPK&Egian Med SHPK, OE Samire Osmani&Besim Zejnullahu janë të papërgjegjshëm ashtu siç e ka cekur edhe autoriteti kontraktues.

OE "Samire Osmani&Besim Zejnullahu nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe të sigurimit të tenderit brenda afatit të kërkuar.

OE **"Vlera SHPK&Egian Med SHPK"** nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe të sigurimit të tenderit brenda afatit të kërkuar.

OE **"Monuni"** nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe të sigurimit të tenderit brenda afatit të kërkuar.

OE DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K shtë i papërgjegjshëm me vendim të OSHP-së dhe për shkak se ka ofertuar me preparatet me substanca active Sulfur që nuk janë të lejuara.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*.

Po ashtu AK-ja e ka favorizuar OE të rekomanduar për kontratë duke e shpall fitues edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm, ndërsa anë këtë rast ka rënë ndesh edhe me paragrafin 6 të nenit 7 pika (vi) ku shkruan që Autoriteti kontraktues duhet të sigurohet që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **Flomed SH.P.K.**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në
RIVLERSIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj në shumë të konsiderueshme.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*